



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut



GREEN
CLIMATE
FUND

Thirrje e Hapur për Projekt-ide

për mbështetje financiare nga Fondi i Gjelbër
Klimatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut
(2019)

Thirrje e Hapur për Projekt-ide për mbështetje financiare nga Fondi i Gjellbër Klimatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2019)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Kabineti i Zëvendës Kryeministrit të Qeverisë për Çështje Ekonomike si Organ Kombëtar i Emëruar (OKE) për Fondin e Gjellbër Klimatik shpall Thirrje për dorëzim të projekt-ideve që trajtojnë dhe i përgjigjen sfidës së ndryshimeve klimatike.

Kjo Thirrje e Hapur ka për qëllim të identifikojë projekt-ide me potencial për zbutje/përshtatje të klimës që të shqyrtohen në nivel kombëtar për t'u dorëzuar tek Fondi i Gjellbër Klimatik (GCF) për financim.

1. Informata bazë mbi Fondin e Gjellbër Klimatik

Fondi i Gjellbër Klimatik (GCF) është fond i ri global krijuar nga Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) që mbështet përpjekjet e vendeve në zhvillim për të trajtuar sfidën e ndryshimeve klimatike (<https://www.greenclimate.fund/home>). Parimet kryesore të GCF, si fond global janë promovimi i zhvendosjes së paradigmës në emetime të nivelit të ulët dhe zhvillimi i qëndrueshëm klimatik.

GCF u krijua nga 194 vende pjesëmarrëse në Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në vitin 2010, si pjesë e Mekanizmit Financiar të Konventës. Ky Fond, udhëhequr nga parimet dhe dispozitat e Konventës, ka për qëllim ndarje të barabartë të resurseve për masat zbutëse dhe ato të përshtatjes. Financimi i përgjithshëm i planifikuar i GCF për momentin është 10,3 miliardë USD dhe mobilizimi i resurseve po vazhdon.

GCF financon projekte dhe programe për emetime të ulëta (zbutje) dhe për klimë të qëndrueshme (përshtatje) hartuar nga sektori publik dhe ai privat për të kontribuar në prioritetet e vendeve lidhur me ndryshimet klimatike. Projektet ndërsektorale që japin përfitime të dyfishta si në zbutje ashtu edhe në përshtatje poashtu kanë të drejtë për financim nga GCF. Çdo projekt apo program i propozuar duhet të demonstrojë arsyetim klimatik për sa i përket zbutjes, përshtatjes, apo që të dyjave dhe duhet të identifikojë se në cilën fushë të impaktit GCF po kontribuon (për një projekt ose program individual, mund të vlejnjë më shumë fusha impakti).

GCF dallon **tetë fusha strategjike impakti** ku investimet e targetuara GCF do kishin impakt më të madh; të ashtuquajturat "fushat e rezultateve" janë referenca për angazhimin me Fondin dhe në këtë drejtim, sipas prioriteteve të vendit, propozim projektet duhet të ndjekin dhe të jenë në përputhje me fushat strategjike të impaktit sipas GCF (paraqitur tek Figura 1).




Figura 1: Fushat strategjike të impaktit sipas GCF

GCF ofron grante, kredi koncensionare, garanca dhe kapital për financim të projekteve që për nga madhësia mund të jenë mikro (USD<10 milionë) deri në projekte të mëdha (USD > 250 milionë). Gjithashtu, në dispozicion janë edhe resurse në formë grantesh për të mbështetur vendet në përgatitje dhe përmirësim të angazhimit me Fondin e Gjelbër Klimatik, si dhe për të përgatitur propozim projektet.

Pronësia shtetërore është parim thelbësor i GCF; në këtë drejtim, Fondi promovon rëndësinë e qasjes që udhëhiqet nga vetë vendi, përf forcimin e përfshirjes relevante të institucioneve relevante dhe palëve relevante në nivel kombëtar.

2. Qëllimi i Thirrjes së Hapur për Projekt-ide

Kjo thirrje ka për qëllim të inkurajojë dhe mbështesë të gjitha palët e interesuara në hartimin e projekt-ideve me potencial për zbutje/përshtatje (ose që të dyja), si hap i parë në procesin e hartimit të propozim projekteve.

3. Miratimi i Projekt-ideve

Projekt-idetë dërguar Organit Kombëtar të Emëruar (OKE) do kalojnë procedurën e kualifikueshmërisë dhe prioritetimit për tu përcaktuar mundësia e përfshirjes në Programin Punues Shtetëror për GCF. Ideja e projektit duhet të jetë në përputhje me sektorët prioritarë për zbutje dhe përshtatje, siç përshkruhet tek dokumentet nacionale strategjike (Komunikimi i Tretë Nacional mbi Ndryshimet Klimatike – për prioritetet e përshtatjes dhe Raporti i Dytë Dyvjeçar Mbi Ndryshimet Klimatike – për prioritetet e zbutjes), si dhe me fushat e impaktit sipas GCF. Të gjitha dokumentet relevante gjenden në faqen zyrtare të internetit: www.greendevlopment.mk.

4. Sektorët prioritarë nacionalë /aktivitetet për zbutje dhe përshtatje

Projekt-ideja duhet të propozojë aktivitete që i përkasin të paktën një sektori prioritar nga sektorët prioritarë nacionalë me potencial të lartë për zbutje/përshtatje siç shfaqen tek Tabela 1 në vijim:

Tabela 1. Sektorët prioritarë nacionalë me potencial të lartë për zbutje/përshtatje

Sektorët prioritarë me potencial të lartë për zbutje	Sektorët prioritarë me potencial të lartë për përshtatje
Energjia – Industritë e energjisë	Burimet e ujit
Energjia – Prodhim dhe ndërtim	
Energjia – Transport	
Bujqësia dhe Pylltaria dhe përdorimi tjetër i tokës (AFOLU) – Bagëtia/Pylltaria/Përdorimi i tokës	Bujqësia – E përgjithshme / vreshtaria/ prodhimi i bagëtisë
Mbetjet – Hedhje e mbeturinave të ngurta	Biodiversiteti
	Shëndeti njerëzor
	Trashëgimia kulturore

Lista e aktiviteteve prioritare (zbutje dhe përshtatje) jepet tek SHTOJCA 2 e kësaj Thirrjeje të Hapur për Projekt-ide.

5. Vlerësimi i kualifikueshmërisë së projekt-idesë

Çdo projekt-ide duhet të plotësojë të gjitha kriteret në vijim:

- Ketë qëllime që përputhen me qëllimet e politikave dhe strategjive nacionale klimatike;
- Përputhet me indikatorët relevantë nacionalë për zhvillim, duke mundësuar korniza institucionale dhe të politikave;
- Përputhet me të paktën një nga tetë fushat e rezultateve strategjike të GCF;
- Trajtojë çështje relevante për integrim të gjinisë dhe grupeve të tjera të cënueshme dhe të përshkruajë se si ripërtërirja/zbutja e ndryshimeve klimatike ndikon si tek meshkujt ashtu edhe tek femrat ose të sigurojë që gratë do kenë përfitime të barabarta nga aktivitetet e projektit

Do konfirmohen dhe prioritetizohen më tutje vetëm ato projekt-ide që kalojnë kontrollin administrativ dhe vlerësimin për kualifikim përmes kriterëve të caktuara për prioritetizim, dhe pas kësaj propozuesi do njoftohet. Më shumë informata mbi kriteret e prioritetizimit mund të gjeni tek Udhëzimet për aplikantët dhe mekanizmin nacional të prioritetizimit në faqen www.greendevlopment.mk.

6. Prioritetizimi strategjik i projekt-ideve

Kriteret në vijim do përdoren gjatë prioritetizimit strategjik për të gjitha projekt-idetë me të drejtë për tu zgjedhur:

- (Qartësia dhe konsistenca në përshkrimin e problemit dhe arsyetimi logjik i aspektit klimatik, qëllimet e projektit dhe rezultatet që priten);
- **ë do zbatojë projektin** (Niveli i përvojës dhe aftësitë e subjekteve zbatuese/partnerët dhe projektet e ngjashëm që tashmë janë implementuar);
- **zgjatja e planifikuar e projektit** (Korniza kohore ku prezantohet kohëzgjatja e aktivitetëve të propozuara); (Statusi momental i projekt-idesë);
- **r të mbështetur procesin nacional të anëtarësimit në BE** (Numri i kriterëve të BE-së me të cilat përputhet projekt);
- **llimet e projektit në përputhje me prioritetet nacionale QZHQ** (Numri i Qëllimeve

- për Zhvillim të Qëndrueshëm që ndikohen ose nxiten nga zbatimi i projektit);
- **ë nacionale për ndryshime klimatike** (Koherenca dhe përputhja e qëllimeve të projektit me prioritetet që tashmë janë trajtuar në strategjitë dhe politikën nacionale për ndryshimet klimatike)
- **Vlerësim preliminar** –(Vlerësim preliminar i potencialit për zbutje/përshtatje si dhe barazisë gjinore dhe potenciali i ndikimit tek gratë dhe burrat veç e veç si dhe tek grupet e tjera të cënueshme)

Për informata të mëtejshme mbi kriteret e prioritetimit për projekt-idetë, ju lutemi referojuni Udhëzimeve për aplikantët që mund t'i gjeni në www.greendevlopment.mk.

Të gjitha projekt-idetë që plotësojnë kushtet dhe që prioritetizohen do konfirmohen dhe përfshihen në Programin Punues të GCF në Maqedoninë e Veriut. Propozuesit e Projekt-ideve të konfirmuara do inkurajohen të kontaktojnë Subjekte të Akredituar për zhvillim të mëtejshëm të Projekt-idesë në Koncept/ Propozim-Projekt të plotë GCF në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me OKE.

7. Kush mund të aplikojë?

Kjo thirrje është e hapur për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë edhe institucionet akademike, autoritetet kombëtare, ndërmarrjet publike dhe ato private, OJQ-të dhe personat e tjerë juridikë, pra inkurajohet çdo subjekt juridik për të hartuar ide për projekt.

8. Si bëhet aplikimi?

Aplikuesi duhet të plotësojë shabllonin e Projekt-idesë në gjuhën angleze, përmes shabllonit elektronik që mund të gjehet në www.greendevlopment.mk. Shabllonet jepen të bashkangjitura edhe tek SHTOJCA 1 e kësaj Thirrjeje për referencë të aplikuesve, por projekt-ideja mund të dorëzohet në mënyrë elektronike përmes faqes së internetit vetëm nga ana e përdoruesve të regjistruar.

Para se të fillojnë hartimin e projekt-idesë, çdo propozues duhet të regjistrohet në www.greendevlopment.mk/login, për të pasur qasje tek shabllonet për projekt-ide. Shablloni i Projekt-idesë duhet plotësuar me të gjitha informatat që kërkohen, të dhënat dhe dokumentet e bashkangjitur (p.sh., harta me vendndodhjen e projektit; lista e të punësuarve që do jenë përgjegjës për zbatimin e projektit dhe lista referente me të dhëna relevante lidhur me përvojat e ngjashme nga e kaluara, etj.). Për udhëzime të detajuara për plotësim të shabllonit të Projekt-idesë ju lutemi referojuni Udhëzimit për hartim të propozim projekteve për GCF, që mund ta gjeni në www.greendevlopment.mk. Çdo informatë tjetër lidhur me punën e Fondit të Gjellbër Klimatik dhe mekanizmat e vendit për angazhim në këtë Fond gjithashtu mund të gjeni në faqen e internetit të OKE: www.greendevlopment.mk.

SHËNIM: Shabllonet e plotësuar të Projekt-ideve nuk duhet të tejkalojnë maksimumin e 5 faqeve, pa përfshirë shtojcat dhe duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike të plotësuar dhe firmosura sipas kriteve.

Çdo dokument plotësues që duhet dorëzuar bashkë me shabllonin e Projekt-idesë duhet të ngarkohet në fazën finale të plotësimit të Formularit për Aplikim online.

Propozuesit mund të zgjedhin të dorëzojnë propozimet për secilën nga 3 fazat e zhvillimit: Projekt-ide, Koncept dhe Propozim i plotë Projekti; shabllonet për këto dokumente mund t'i gjeni në faqen e internetit të OKE.

Në rastet kur OKE pranon Koncept ose Propozim-projekt të plotë (në shabllonin e GCF) nga një institucion nacional ose nga një Subjekt i Akredituar Ndërkombëtar (si përgjigje e ndonjë thirrjeje për propozime ose si aplikim spontan), OKE do zhvillojë të gjitha fazat e sigurimit të cilësisë në përputhje me procedurën, pa marrë parasysh se sa i avancuar është hartimi i propozimit. Prandaj, aplikuesit duhet patjetër të plotësojnë shabllonin online për Projekt-ide në fillim, ku do tregojnë statusin e hartimit të projektit (Ide, Koncept ose Propozim i plotë), dhe pas pranimit ose letrës aprovuese nga OKE, aplikuesit do inkurajohen të dorëzojnë Konceptin ose Projekt-idenë ashtu siç e kanë hartuar.

9. Afati për dorëzim të projekt-idesë

Të interesuarit mund të dorëzojnë Dokumentin e Idesë së kompletuar të Projektit jo më vonë se 15 dhjetori 2019 (ora 16:00).

Udhëzime të detajuara për plotësim të shabllonit për Projekt-ide dhe informata të tjera lidhur me këtë thirrje për projekt-ide ose lidhur me punën e Fondit të Gjelbër Klimatik mund të gjehen tek faqja e internetit e OKE: www.greendevlopment.mk.




Të gjithë propozuesit do informohen nëse projekt-ideja e tyre është pranuar dhe bëhet pjesë e Programit Nacional Punues të GCF, ose nëse projekt-ideja e tyre është refuzuar me komente për përmirësim. Programi Nacional Punues i GCF do jetë dokument publik.



10. Orari indikativ për vlerësim të projekt-idesë

Plani indikativ për dorëzim dhe vlerësim/prioretizim të projekt ideve jepet tek grafiku më poshtë.



11. Hartimi i Konceptit /Propozim projektit të plotë dhe dorëzimi në GCF për mbështetje financiare

Propozuesit duhet të kenë parasysh që partneriteti me Subjekt të Akredituar (SA) duhet të bëhet para dorëzimit të Konceptit /Propozim projektit të plotë tek OKE; megjithatë në rastet kur propozuesi nuk ka gjetur një SA të përshtatshëm për bashkëpunim, pas konfirmimit të kualifikimit të projekt-idesë të tyre, OKE do mbështesë propozuesin në kërkimin e SA të përshtatshëm sipas listës ekzistuese të subjekteve të akredituar për GCF dhe kapacitetet e tyre respektive; këto SA do bëjnë partneritet me propozuesit e projektit dhe OKE do zhvillojë projekt-idenë në koncept/propozim projekt të plotë dhe do udhëzojë propozuesin lidhur me ciklin e projektit të GCF.

Termi 'i akredituar' do të thotë që këto subjekte kanë kaluar procesin e akreditimit të GCF dhe plotësojnë standardet e Fondit (institucione publike, private ose jo-qeveritare). Listën e plotë të subjekteve të akredituara mund ta gjeni në faqen e internetit të GCF (<https://www.greenclimate.fund/how-we-work/tools/entity-directory>).

Gjatë konfirmimit të kualifikueshmërisë së Projekt-ideve nga OKE, SA do hartojë dhe dorëzojë Konceptet/Propozim projektet e plota në GCF në bashkëpunim me institucionet/propozuesit nacionalë. SA duhet të koordinohet me OKE lidhur me planifikimin e projektit në faza, aprovimin e propozimeve për financim dhe zbatimin e projektit. Për hartim të Koncepteve /Propozim projekteve të plota, propozuesit duhet të përdorin shabllonet e GCF (www.greenclimate.fund) që mund të gjehen edhe tek faqja e internetit e OKE: www.greendevlopment.mk.

Koncepti i hartuar nga Subjekti i Akredituar dhe propozuesit do i dorëzohet OKE për **vlerësim teknik** dhe duhet shoqëruar nga këto dokumente plotësuese:

1. Hartë që tregon vendndodhjen e projektit/programit,
2. Diagram që përshkruan teorinë e ndryshimit,
3. Model ekonomik dhe financiar me supozimet kryesore dhe skenarët potencialë të theksuar,
4. Studim para-fizibiliteti,
5. Raport vlerësues të projekteve paraprake (vlen për projektet që përsërisin investimet e mëparshme),
6. Rezultate nga analizat e shqyrtimit të rrezikut social dhe rrezikut të mjedisit jetësor

Vlerësimi teknik i Koncepteve/Propozim-projekteve të plota do bëhet sipas kritereve në vijim:

- **Projektit** –Ndikimet e parashikuara të zbutjes/përshtatjes, niveli i rreziqeve të mbetur lidhur me projektin dhe masat e duhura të zbutjes përkufizuar ashtu që plotësojnë kriteret e Standardeve të Ambientit dhe atyre Sociale (ESS)
- **r zhvendosje të paradigmës** – potenciali për të inicuar ndryshime në politika, dokumente të reja strategjike ose rregullativa të reja që do hartohen, mundësi që projekti të përsëritet në disa rajone në RMV dhe niveli i këmbimit të mësimave të marra dhe përvojave të fituara nga projekti, niveli i elementeve dhe konceptit inovativ në suazat e aktiviteteve të projektit
- **r zhvillim të qëndrueshëm** – përfitime të pritura të përbashkëta mes fushave të ambientit jetësor, fushës sociale dhe shëndetit, dhe ekonomisë, duke përfshirë edhe ndikimin në zhvillim të çështjeve gjinore (p.sh. llojet e përmirësimeve në mediat dhe sektorët për mjedisin jetësor, numri i përgjithshëm i vendeve të krijuara të punës (të drejtpërdrejta dhe indirekte) me zbatim të projektit, etj.)
- **r nevojat e vendit** - % e popullatës socio-ekonomike që do përfitojë nga projekti, aktivitetet të specifikuar për forcim të kapaciteteve institucionale dhe zbatuese në RMV
- **si e vendit** –Koherencë dhe përputhje e qëllimeve të projektit me prioritetet që tashmë trajtohen në politikën nacionale klimatike, në rregullativat lidhur me klimën, ligjin dhe strategjitë, përputhje e projektit me agjendën nacionale për zhvillim, angazhim i palëve relevante.
- Qëndrueshmëri ekonomike dhe financiare e projekteve, mundësi për të kombinuar disa burime të financimit, niveli i teknologjive të praktikave më të mira që planifikohen të zbatohen tek projekti dhe të arrihen përfitimet kryesore.

Informata të mëtejshme lidhur me këto kriteret mund të gjehen në www.greendevlopment.mk.

Verifikimi i procedurës së mos-kundërshtimit është hapi i fundit për sigurim të cilësisë, në mënyrë që aplikuesi të marrë **Dokumentin e mos-kundërshtimit** nga OKE për ta dorëzuar tek GCF. Procedura e Mos-kundërshtimit është mjete kryesor për të siguruar pronësi të plotë të vendit sa i përket propozimeve dhe siguron pasqyrë të përputhjes së investimeve të propozuara me prioritetet e vendit.

Sigurimi i cilësisë përfshin pyetjet dhe dëshmitë që propozimi ka kaluar aspektin teknik, që të gjitha komentet e marra gjatë vlerësimit teknik janë trajtuar tek propozimi, që SA ua ka prezantuar

propozimin organeve të vendit, që propozimi është në Programin Punues të Vendit, që janë organizuar konsultat me palët relevante që përmenden, etj.

Nëse propozimi aprovet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, OKE lëshon dokument të mos-kundërshtimit për propozimin në përputhje me rrethanat dhe Propozim-projekti i plotë mund t'i dorëzohet GCF-së për vlerësim që të mund të fitojë mbështetjen financiare. Propozuesit duhet ta kenë parasysh që Propozimet e Financuara të pashoqëruara me dokumentin e mos-kundërshtimit të nënshkruar nga OKE i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk do merren parasysh nga Sekretariati i GCF.

12. Pyetje dhe përgjigje

Për të marrë përgjigje për pyetjet që mund të keni gjatë fazave të hartimit të projektit (projekt ideja/ koncepti /propozim projekti i plotë), lidhur me përgatitjen dhe plotësimin e shablloneve të aplikimit, afatet, etj, ju lutemi konsultoni seksionin me pyetje dhe përgjigje - Q&A në faqen e internetit të OKE: www.greendevlopment.mk, ose kontaktoni personat përgjegjës për OKE. Seksioni me pyetje dhe përgjigje -Q&A do azhurnohet rregullisht sipas pyetjeve që do parashtrajnë propozuesit.

Shtojca 1: Shablloni i Projekt-idesë

Projekt-ide

Titull:

Shënim mbi Projekt-idenë

Ky shabllon për projekt-ide mund të përdoret nga Aplikuesit që zgjedhin të dorëzojnë dokument të Projekt-idesë për t'u shqyrtuar nga Organi Kombëtar i Emëruar, ose Aplikuesit e interesuar për t'u përgjigjur në ndonjë thirrje të caktuar për propozime të shpallur nga OKE.

Kjo Projekt-ide do shqyrtohet nga OKE përmes kriterëve të kualifikimit që tashmë janë caktuar dhe do aprovoen vetëm projekt-ide që plotësojnë kushtet dhe do përfshihen si pjesë e Programit Punues të Vendit. OKE do ju dërgojë letër aprovimi aplikuesve për t'iu konfirmuar aprovimin e idesë, ose për të informuar aplikantin për refuzimin e projekt-idesë dhe për të dhënë rekomandime për përmirësim.

Aplikuesit e Projekt-ideve të aprovuara do inkurajohen të zhvillojnë më tutje idenë në Koncept sipas shablloneve të GCF dhe në konsultim të afërt me përfaqësues të OKE. Në fazën e Konceptit, do gjetet Subjekt i Akredituar për të mbështetur dhe hartuar propozim-projektet sipas fushës së punës, dhe kriterëve për akreditim të një subjekti të caktuar të akredituar, duke përfshirë madhësinë e projektit për të cilin ky subjekt është i akredituar për implementim, fushën/sectorin e ekspertizës dhe Kategorinë e Rrezikut Social dhe atij të Mjedisit Jetësor që subjekti është në gjendje ta menaxhojë.

Aplikuesit duhet të përdorin versionin elektronik të Dokumentit të Projekt-idesë të cilin mund ta plotësojnë online (Formulari për aplikim Online) duke përdorur fjalëkalimin e tyre për qasje. Pas procesit të regjistrimit, përdoruesi do shohë panel me formular me pyetje të paracaktuara (Dokumenti i Projekt-idesë). Pas dorëzimit të Dokumentit të Projekt-idesë, Aplikuesi do marrë e-mail me informatën që dorëzimi i Projekt-idesë ka qenë i suksesshëm.

Udhëzime të detajuara për plotësim të këtij shablloni dhe informata të tjera lidhur me punën e Fondit të Gjelbër Klimatik mund të gjeni në: www.greendevelopment.mk

Informata të përgjithshme mbi projektin	
Titulli i Projektit:	
Projekt ose Program	<input type="checkbox"/> Projekt <input type="checkbox"/> Program
Kohëzgjatja e projektit (muaj):	
Vendndodhja gjeografike e aktiviteteve të projektit (ju lutemi, bashkangjitni hartën tek Shtojca):	
Subjekti/et Zbatuese (titulli, lloji i organizatës, adresa, personat për kontakt) <i>Ju lutemi, në Shtojcë inkuadroni Listë me të punësuar që do jenë përgjegjës për zbatim të projektit (të veçuar sipas gjinisë dhe arsimimit) për secilin subjekt</i>	Titulli: Lloji i organizatës: Adresa: Personi për kontakt: Telefoni/adresa e-mail:
Përvoja të mëparshme në zbatim të projekteve të ngjashëm (me ngjashmëri për sa i përket kompleksitetit, shpenzimeve dhe kohëzgjatjes)	<i>Ju lutemi, shkruani të paktën dy projekte të ngjashëm të përfunduar duke dhënë informata për shpenzimet e projektit, qëllimin e projekteve, përfituesin kryesor dhe rezultatet kryesore. Si Shtojcë mund të bashkangjitni Listë Referente me të dhënat më relevante lidhur me përvojat e mëparshme</i>
Statusi i projektit:	<input type="checkbox"/> Propozim Projekt i plotë <input type="checkbox"/> Koncepti <input type="checkbox"/> Projekt-ideja
Fokusi klimatik i Projektit dhe fushat e rezultateve	
Fusha ku fokusohet projekti:	<input type="checkbox"/> Zbutje <input type="checkbox"/> Përshtatje <input type="checkbox"/> Prek të dy fushat

Fushat e rezultateve strategjike të Fondit të Gjellbër Klimatik

(Cila nga fushat e targetuara të rezultateve strategjike të GCF i trajton projekti i propozuar?)

u lutemi, etiketoni më të rëndësishmet

Zbutje

Duke ulur emetimet e gazrave serrë:

Qasje në energji dhe gjenerim i energjisë

(p.sh. qasje në sistem brenda rrjetit ose jashtë rrjetit (që i plotëson vetë kërkesat personale për energji), ku energjia gjenerohet nga burime të qëndrueshme të energjisëm si p.sh. me diell, erë, ujëra gjeotermale, etj.)

Transport me emetim të ulët

(p.sh. trena me shpejtësi të madhe, sistem i autobusëve të shpejtë, etj.)

Objekte, qytete dhe industri dhe pajisje

(p.sh.ndërtesa të reja dhe të rinovuara me efikasitet energjetik, pajisje me efikasitet energjetik për kompanitë dhe menaxhim i zinxhirit të furnizimit, etj.)

Pylltaria dhe përdorimi i tokës

(p.sh. mbrojtja dhe menaxhimi me pyjet, ujitje bujqësore, trajtim dhe menaxhim me ujërat, etj.)

Përshtatje në ndryshimet klimatike

Duke rritur ripërtëritjen në këto sfera:

Njerëzit dhe bashkësitë më të cënueshme

(p.sh. zbutje e rreziqeve negative lidhur me ndryshimet klimatike, krijimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm, krijim i sistemeve për shërbime të sigurimit, etj.)

Shëndeti dhe mirëqenia dhe siguria e ushqimit dhe ujit

((p.sh. sigurim i ujit të pastër për pije për popullatën, zbatimi i teknologjive për kursim të ujit, etj.)

Infrastruktura dhe mjedisi i ndërtuar

(p.sh. infrastrukturë për mbrojtje nga orteku dhe orteku i baltës, sisteme për ajrosje, rrjete të qëndrueshme rrugore, etj.)

Ekosistemi dhe shërbimet e ekosistemit

(p.sh. mbrojtja dhe menaxhimi me ekosistemin, ekoturizmi, etj.)

Përshkrimi i projektit (maks. 3 faqe)	
Qëllimi i projektit:	
Qëllimet e projektit	<i>(sipas mundësisë, ju lutemi përkufizoni qëllimet e veçanta lidhur me çështjet gjinore dhe çështjet e pakicave dhe ndryshimeve klimatike)</i>
Përfituesi kryesor nga projekti (I drejtpërdrejtë dhe indirekt) të ndarë sipas llojit të cënueshmërisë	
Justifikim i shkurtër i projektit (koherenca dhe përputhja me prioritetet nacionale klimatike të vendit dhe strategjitë e zhvillimit si dhe SDG nacionale)	
Përshkruani shkurt problemin e Zbutjes/Përshtatjes që ky propozim tenton ta trajtojë	<i>(ju lutemi, specifikoni çështjet relevante për grupet gjinore dhe grupet e cënueshme)</i>
Regjistroni aktivitetet e propozuara të projektit për të trajtuar problemet dhe pengesat e identifikuara më sipër që do sjellin deri tek rezultatet e pritura	<i>(Ju lutemi cekni nëse aktivitetet/proceset e propozuara ose teknologjitë që do realizohen janë inovative. Gjithashtu, jepni shpjegim se si gratë, CSO, akademia, biznesi dhe palë të tjera relevante do përfshihen gjatë implementimit të aktiviteteve të projektit)</i>
Përshkruani shkurt rezultatet e pritura dhe rezultatet e targetuara në aspektin ekonomik (në EUR), social klimatik/mjedis jetësor dhe gjinor	<i>(p.sh. numri i vendeve të reja të punës të krijuara, tonet e emetimeve të reduktuara të CO2 eq., ndikimi i parashikuar i përshtatjes-përfitues të drejtpërdrejtë/indirektë si % e popullatës së përgjithshme, Si do trajtojë projekti çështjet gjinore dhe çështjet lidhur me grupe të tjera të cënueshme?.)</i>
Cekni nëse ka potencial për përsëritje të aktiviteteve të projektit në ndonjë rajon ose vend fqinj dhe përdorim të rezultateve të projektit	
Shpjegoni se pse projekti ka nevojë për financim:	<i>(p.sh. shpjegoni pse kjo nuk financohet nga burime të vendit nga sektori/ët publik/ë/pri- vat/ë)</i>

Aspektet financiare të projektit	
Shpenzimet indikative të përgjithshme të projektit (EUR):	
Kërkesa indikative e financimit nga GCF (EUR):	
Bashkëfinancimi i paraparë (nëse ka) – EUR osë % e shpenzimeve të përgjithshme të projektit	
Lloji i instrumentit financiar që do kërkohet:	<input type="checkbox"/> Grant <input type="checkbox"/> Kredi/Hua <input type="checkbox"/> Tjetër _____
Burime të tjera financiare që pjesërisht do mbulojnë shpenzimet e përgjithshme të projektit:	

Informata mbi aplikantin	
Emri i organizatës/institucionit aplikues(e):	
Lloji i organizatës/institucionit <i>(publik (qeveritar), biznes, OJQ, organizatë ndërkombëtare, institucion akademik, etj.)</i>	
Adresa: <i>(rruga, numri, kodi postar)</i>	
Personi për kontakt:	
Pozita:	
Kontakti <i>(telefoni dhe e-mail):</i>	
Data e dorëzimit të Projekt-idesë për shqyrtim nga OKE	

Dokumentet plotësuese të Dokumentit të Projekt-idesë:

SHTOJCA 1

SHTOJCA 2

SHTOJCA 3

ПРИЛОГ 2 Национални приоритетни сектори и приоритетни активности за ублажување и адаптација

Dokumenti strategjik nacional RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DUVJEÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)		
Lidhja tek dokumenti http://klimataktipromenti.mk/data/frest/files/download/556c445f6c036e3de04502b0db60ed604572ac50e97d28811ef55aac77c5090.pdf	Qëllimi i zbutjes	Përshkrimi i aktivitetit të zbutjes
Energjia – Industritë e energjisë	Ullja e humbjeve në rrejetet e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ngrohjes	Masat operative dhe konstruktive të nevojshme për ullje të humbjeve, implementuar nga operatorët e rrejetve shpërndarëse.
	Rritje e kapacitetit vendor të gjenerimit nga burime të qendrueshme të energjisë	Ndërtim i hidrocentraleve të reja të mëdha
	Rritje e kapacitetit vendor të gjenerimit nga burime të qendrueshme të energjisë	Ndërtim i hidrocentraleve të reja të vogla dhe futja në përdorim e tarifave fleksibile të shitjes për të stimuluar ndërtimin
	Rritje e kapacitetit vendor të gjenerimit nga burime të qendrueshme të energjisë	Ndërtim i centraleve diellore (me më shumë se 10 kW) dhe futja në përdorim e tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin
	Rritje e kapacitetit vendor të gjenerimit nga burime të qendrueshme të energjisë	Ndërtim i centraleve diellore në kulme dhe futje në përdorim e "matjes neto"
	Rritje e kapacitetit vendor të gjenerimit nga burime të qendrueshme të energjisë	Ndërtim i centraleve me erë dhe futja në përdorim i tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin
	Rritje e kapacitetit vendor të gjenerimit nga burime të qendrueshme të energjisë	Ndërtim i centraleve me biogas dhe futja në përdorim i tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin
Rritje e kapacitetit vendor të gjenerimit nga burime të qendrueshme të energjisë	Ndërtim i centraleve që prodhojnë me biomasa (me CHP opsionale) dhe futja në përdorim i tarifave premium të shitjes nga prodhuesi për të stimuluar ndërtimin	

Dokumenti strategjik nacional RAPORTI I DYTË I AZHURNUAR DYVJEÇAR MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE (2017)	
Lidhja tek dokumenti https://klimataktikoromeni.mk.gov.mk/asset/files/download/5534c4491f5c0334e31ae245522b50d862ed04522a5e502e97d28811e155b9e27650909.pdf	
Sektorët prioritarë	Përshkrimi i aktivitetit të zbutjes
Qëllimi i zbutjes Përdorim i nxehtësisë të panevojshme nga REK Manastiri	Ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore në Manastir dhe përdorim i nxehtësisë së tepërt nga REK Manastiri
Ulje e varshmërisë nga importi dhe përdorim më i madh i sistemit të tubacionit të gazit	Ndërtimi i centraleve me gas natyral (CHP)
Arritja e synimeve të caktuara tek Plani i Veprimit për Efikasitet Energjetik dhe Plani i Veprimit për Burime të Oëndrueshme të Energjisë	Instalimi i kolektorëve diellorë termalë për ujë të nxehtë
